



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.6.2024, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Informim për zbatimin e vendimeve të mbledhjes së parë të komisionit.
2. Vendimmarrje për procesin përgatitor për organizimin dhe funksionimin e komisionit dhe projekttagjendën e tij.
 - i) Projektvendim për ftesë publike për bashkëpunim për organizatat ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, si dhe për individët, ekspertë vendas e ndërkombëtarë dhe për shtetas shqiptarë me përvojë në fushat përkatëse, për të kontribuar me ekspertizën e tyre në përmbushje të qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar;
 - ii) Projektvendim për përfaqësimin e disa institucioneve që veprojnë në sektorë me risk për korrupsion me përfaqësues/ekspertë pranë nëngrupit të punës për antikorrupsion të ngritur në Komisionin e Posaçëm Parlamentar;
 - iii) Projektvendim për miratimin e organigramës së sekretariatit teknik;
 - iv) Projektvendim për miratimin e konceptit për ndërtimin e faqes *online* dhe platformës së komunikimit publik.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Shalsi, Milva Ekonomi, Klotilda Bushka, Etilda Gjonaj, Evis Kushi, Toni Gogu, Milva Ekonomi dhe Erion Braçe.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Dhurata Tyli, Flutura Aça dhe Sorina Koti.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje!

Kuorumi është i arritur, kështu që mund ta fillojmë mbledhjen e dytë të këtij komisioni.

Fillimisht dua t'ju them se ne mbetemi të keqardhur që ende opozita nuk po bëhet pjesë e aktivitetit normal të komisionit. Në zbatim të rezolutës së Kuvendit “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”, Kuvendi ka miratuar me vendimin nr. 50, ngritjen e këtij komisioni të posaçëm parlamentar, si dhe me vendimin nr. 53, bazuar në rezolutën e Kuvendit dhe vendimin nr. 50 të tij ka miratuar përbërjen e këtij komisioni parlamentar, duke përcaktuar shprehimisht edhe anëtarët që do të jenë nga mazhoranca dhe nga opozita. Kështu që do të duhej që kolegët deputetë, të nderuar të opozitës, të merrnin pjesë në mbledhje, sipas detyrimit të Kuvendit, por edhe si një nevojë e domosdoshme, si një nevojë jetike, për të qenë pjesë e një procesi të tillë reformues.

Unë shpresoj shumë në reflektimin e tyre dhe besoj se hap pas hapi, duke ecur përpara me procesin përgatitor dhe duke qenë të gjithë ne këtu, edhe opozita gjithashtu, edhe aktorë dhe faktorë të tjerë jashtë politikës, që mund të kenë pikëpyetjet apo perceptimet e tyre për këtë çështje, do të sqarohen më mirë dhe besoj se do ta kuptojnë kushtetutshmërinë, qëllimin e këtij procesi, rëndësinë që ka ky proces për qytetarët, rëndësinë që ka ky proces për integrimin dhe rëndësinë që ka ky proces për të ardhmen e vendit.

Në ditët që do të vijmë, pikërisht duke dëshmuar këtë qasje, duke dëshmuar këtë vullnet, këtë qartësi, këtë vizion në atë çfarë ne duam të bëjmë, besoj se opozita, dhe jo vetëm opozita, por edhe shumë faktorë dhe aktorë të tjerë, të cilët ndërkohë janë ftuar edhe publikisht nga ne, do të jenë pjesë e këtij procesi gjithëpërfshirës, transparent dhe profesional.

Fillimisht do të dëshiroja t'i informoja kolegët se në zbatim të mbledhjes së parë të komisionit, se vendimet që janë marrë në atë mbledhje janë zbardhur, tashmë i keni të gjithë pjesë të dosjes suaj të punës, janë përgatitur shkresat nga Kuvendi. Kuvendi ka caktuar, në përgjigje edhe të kërkesës sonë, stafin që do të jetë pjesë e sekretariatit teknik dhe njësinë mbështetëse që do ta lehtësojë punën e këtij komisioni. Unë dëshiroj t'i falënderoj edhe një herë drejtuesit e Kuvendit për këtë vendimmarrje të shpejtë! Gjithashtu, dua t'u shpreh vlerësimet më të mira të gjithë atyre që janë caktuar pjesë e sekretariatit teknik dhe e stafit mbështetës, të cilët në një kohë mjaft të shpejtë dhe me profesionalizëm kanë bërë të mundur që vendimet e para të Kuvendit të marrin rrugën e duhur në mënyrë që procesi të ecë përpara!

E vlerësoj faktin që disa organizata të shoqërisë civile, ekspertë të ndryshëm me iniciativën e tyre, sapo është miratuar komisioni, sidomos pas mbledhjes së parë të komisionit, drejtpërsëdrejti kanë komunikuar dhe kanë shprehur interes për t'u përfshirë. Unë e vlerësoj këtë moment, i falënderoj ata për gatishmërinë e shprehur, por natyrisht ky është një proces që do të zhvillohet mbi disa rregulla dhe mbi një procedurë që e bën atë të jetë konform Rregullores së Kuvendit dhe transparente. Kështu që në përgjigje në ftesës sonë publike, ne do të mirëpresim shprehjen e interesit prej tyre dhe më pas për të marrë vendimet e nevojshme për t'i përfshirë në këtë proces.

Kjo ishte sa për t'i informuar kolegët lidhur me vendimmarrjet e mbledhjes së mëparshme të Kuvendit dhe ecurinë e punës së deritanishme. Natyrisht, e gjitha është një punë përgatitore dhe organizative, për të filluar më pas procesin nga pikëpamja substanciale. E gjithë kjo fazë përgatitore është tejet e rëndësishme për të pasur atë që ne synojmë, një proces sa më gjithëpërfshirës, sa më transparent dhe sa më profesional, me produkte të qarta dhe të dobishme, në përputhje me qëllimet që ka parashikuar rezoluta dhe vetë vendimi i Kuvendit.

Këto ishin për pikën e parë të rendit të ditës, nëse kolegët nuk kanë ndonjë gjë të veçantë.

Në rregull.

Kalojmë në pikën e dytë, që ka të bëjë me vazhdimin e procesit përgatitor për organizimin dhe funksionimin e komisionit dhe realizimin e agjendës së tij. Projektvendimi i parë, siç e keni në dosje, është një projektvendim që ka të bëjë me nevojën e një ftese publike për bashkëpunim për organizatat ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, si dhe për individët, ekspertë vendas e ndërkombëtarë dhe për shtetas shqiptarë me përvojë në fushat përkatëse, për të kontribuar me ekspertizën e tyre në përmbushje të qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Bazuar në nenet 24 dhe vijues të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën 9, të vendimit nr. 50 të Kuvendit për krijimin e këtij komisioni të posaçëm parlamentar, komisioni i posaçëm parlamentar vendosi t'u drejtohet me një ftesë publike për bashkëpunim organizatave ndërkombëtare që veprojnë brenda dhe jashtë vendit, si dhe individëve, ekspertëve ndërkombëtarë dhe shtetas shqiptarë jashtë vendit, me përvojë të spikatur në fushat përkatëse, që të ofrojnë asistencë dhe ekspertizë në tri fushat, objekt pune i këtij komisioni, për të shprehur interesin për përfshirje aktive në nivel ekspertësh ose edhe në sekretariatit teknik, në tryezat e debatit publik, si dhe për të kontribuar me ekspertizën e tyre në proceset që do të ndërtojnë ky komision dhe sidomos grupi i ekspertëve.

Kjo ishte përmbajtja e projektvendimit.

A ka ndonjë nga kolegët sugjerime?

Po, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj se duke i mëshuar shumë fort faktit të ekspertizave, kryesisht të ekspertëve shqiptarë që janë në vende të ndryshme të Europës, një pjesë e tyre sot japin kontributin ose janë të punësuar në universitet e drejtësisë në disa vende, ndoshta do të duhet të gjenden edhe mënyra komunikimi të tilla që të kemi mundësi t’i tërheqim këta pedagogë apo profesorë, sidomos ata të fushës së drejtësisë, por jo vetëm, apo të gjejmë forma proaktive që të kemi mundësi t’i kemi pjesë të grupit të ekspertëve. Shumë prej tyre janë pedagogë në Angli, në Holandë apo në Gjermani, të cilët kanë vërtet mundësinë edhe të kontribuojnë në këtë fushë, për më tepër pastaj e kemi mundësinë të tërheqim më shumë ekspertë shqiptarë, që mund të japin kontribut edhe për vendin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nuk e di se çfarë mund të shtojmë te kjo që thatë ju, se ne e kemi thënë qartë: “shtetas shqiptarë jashtë vendit me përvojë të spikatur në fushat përkatëse”, që e përmbledh këtë që thatë ju. Besoj se biem dakord, apo jo?

Nuk ka ndonjë gjë të re?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, dakord. U kuptuam për metodologjinë.

Dakord.

A ka ndonjë gjë tjetër. A jeni dakord me projektin?

Faleminderit!

Projektvendimi i dytë lidhet me përfaqësimin: projektvendim për përfaqësimin e disa institucioneve, që veprojnë në sektorë me risk për korrupsion me përfaqësues/ekspertë pranë nëngrupit të punës për antikorrupsion të ngritur në komisionin e posaçëm parlamentar.

Bazuar në Rregullore, paragrafin e dytë të pikës 8 të vendimit nr. 50 të Kuvendit të Shqipërisë, komisioni i posaçëm parlamentar vendosi t’u drejtohet institucioneve publike, të cilat ushtrojnë funksione sipas vlerësimit të bërë në raportet e BE-së, në fusha me risk për korrupsion, si në prokurimet publike, prona, arsim, shëndetësi, tatime, dogana e të tjera që deri në datën 30.6.2024 të propozojnë përfaqësuesit/ekspertët, me të cilët do të përfaqësohen për të bashkëkontribuar me ekspertizën e tyre pranë nëngrupit të punës për antikorrupsionin, i ngritur në komisionin e posaçëm parlamentar.

Në bëmë një konsultim paraprakisht edhe me ministrinë, me Kryenegociatoren, por edhe nga materiali që ka paraqitur Kryenegociatorja dhe nga raport i progresit këto janë fushat kryesore të identifikuara si sektorët me risk të lartë për korrupsion dhe në të cilat do të jetë i fokusuar i gjithë aktivitetit i këtij komisioni, veçanërisht i grupit që ka të bëjë me çështjet e antikorrupsionit. Nëse ka ndonjë shtesë në këtë moment, mirë, nëse jo, gjatë rrugës, në proces edhe mund t'i thoni. Lista është shumë më e gjatë, pra ajo që ka përcaktuar progresraporti i BE-së, por ne morëm ato që janë me risk shumë më të lartë dhe që kanë efekt të drejtpërdrejtë te qytetari.

Kjo është, pak a shumë, përmbajtja.

A keni ndonjë sugjerim?

A biem dakord? Dakord.

Faleminderit.

Projektvendimi tjetër ka të bëjë me sekretariatit teknik. Bazuar ne Rregulloren e Kuvendit dhe në pikën 10 të vendimit, komisioni i posaçëm do të miratojë strukturën dhe organigramën e sekretariatit teknik, që do të funksionojë në mbështetje të grupit të ekspertëve, nëngrupeve të tij, pranë komisionit të posaçëm parlamentar, sipas aneksit që keni bashkëngjitur. Përbërja dhe drejtimi i sekretariatit teknik dhe i nëngrupeve të tij do të miratohen në vijim nga komisioni i posaçëm parlamentar. Pranë grupit të ekspertëve teknikë dhe sekretariatit teknik funksionon njësi mbështetëse me specialistë dhe këshilltarë të stafit të Kuvendit. Përbërja e njësisë mbështetëse miratohet nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Ky është projektvendimi për sekretariatit teknik për ta bërë efektiv, meqenëse në mbledhjen e mëparshme ne u kërkuan edhe institucioneve të sjellin emrat, ato po i sjellin, sepse është e domosdoshme për t'i hapur rrugë këtij procesi.

A ka ndonjë sugjerim për këtë gjë? Dakord.

Së fundi, e kemi të domosdoshme të krijojmë një faqe publike *online* dhe një platformë komunikimi publik për të pasqyruar veprimtarinë e komisionit dhe për të ndërvepruar me ekspertët dhe opinionin e gjerë publik.

Natyrisht, do të ngarkohen sekretariati teknik dhe njësi përgjegjëse për ndjekjen dhe mbikëqyrjen në vijim të këtij procesi. Kostot e nevojshme për hostimin dhe programin e saj do të mbulohen nga Kuvendi.

Para se të shohim një prezantim të shkurtër, a keni ndonjë gjë për të thënë në princip?

Po. Zoti Shalsi.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Është shumë i rëndësishëm për të gjithë ne, por edhe për opinionin publik, ndërtimi i kësaj platforme, që duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme, lehtësisht e përdorshme. Përpos faqes publike *online*, unë doja të sillja në vëmendjen tuaj që ka rrjete sociale, për shembull *LinkedIn*, që, ndryshe nga rrjetet e *Facebook*-ut apo *Instagram*-it, ka një kontingjent profesionistësh të spikatur, edhe në vijim të asaj që tha kolegja Etilda, ku do të duhet të bëhemi pjesë. Pra, të mos mbetemi te platforma *uebsajti*, me sa kuptoj, i tillë do të jetë koncepti, por të aktivizohen edhe platforma, si *LinkedIn*, që është një rrjet i njohur gjerësisht për profesionistët. Këtë e kisha më shumë si sugjerim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se do të jetë në vëmendjen e sekretariatit teknik dhe të njësisë mbështetëse, për ta reflektuar. Për hir të së vërtetës, që të jem i sigurt dhe korrekt, zonjat dhe zotërinjtë, që janë marrë me këtë gjë, e propozuan. Unë mendova sa mundësi kemi për ta mbajtur dhe për ta mirëmbajtur, gjithsesi mbetet për t'u parë nga ana e tyre se sa do të realizohet, se unë nuk jam ekspert, nuk e njoh këtë fushë.

Në parim, a jemi dakord për këtë gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, do ta shikojmë. E mbyllim pjesën e vendimmarrjes që të bëjmë pjesën teknike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, një koncept.

Po, zoti Gogu.

Toni Gogu – Një ndërhyrje për procedurë, meqenëse vendimi propozon që ne miratojmë konceptin, do të ishte mirë që ta shqyrtonim atë, pastaj të kishim vendimmarrjen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

Dritani do të bëjë një prezantim. E mbyllim, se prezantimi nuk ka shumë interes për publikun.

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit
Elvi Prifti